



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 99
Prishtinë, më 11 shkurt 2010

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 11 SHKURT 2010**

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetari i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 72 deputetë.

Ai njoftoi për tre deputetët e zëvendësuar, pas zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009: në vend të deputetit Agim Veliu, Lutfi Zharku, në vend të deputetit Rasim Selmanaj, Bujar Dugolli dhe në vend të Bojan Stojanoviq, Petar Miletqi.

Para procedimit me rendin e ditës, për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Deputeti **Bujar Dugolli** tha se tha se aktivitetin e vet në Kuvend nuk do ta zhvillojë në kuadër të Grupit Parlamentar të AAK-së, por do të veprojë si deputet i pavarur.

Deputetja **Gjylnaze Syla** tha se kërkesën e punëtorëve shëndetësor për rritje pagash, Grupi Parlamentar i AAK-së e përkrah në tërësi. Ajo pyeti se prej nga do të mirren mjetet financiare për rritjen e pagave të punëtorëve shëndetësorë?

Ministri **Alush Gashi** tha se e gëzon mbështetja për reformat në Shëndetësi, kurse sa i përket rritjes së pagave për këtë kategori, ato janë paraparë me Kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Deputeti **Branislav Gërbiç** kërkoi që Grupi Parlamentar për Integritet të përfaqësohet në Kryesinë e Kuvendit, me rotacion.

Kryetari tha se Komuniteti serb është i përfaqësuar në Kryesinë e Kuvendit me një anëtar. Për rotacionin e mundshëm të tij, përfaqësuesit e komunitetit serb duhet të merren vesh se kush i përfaqëson ata.

Kryeministri **Hashim Thaçi** paraqiti qëndrimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me kërkesat për rritjen e pagave të punëtorëve të shëndetësisë dhe të sektorëve të tjerë. Ai bëri një krahasim të pagave të sektorit publik të qeverive të mëparshme dhe të Qeverisë së tanishme, e cila do të vazhdojë me rritjen e pagave për të gjithë të punësuarit në sektorin publikë, në përputhje me shkallën e zhvillimit të vendit dhe mundësitë buxhetore të Qeverisë.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2010, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi në vazhdim i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 28 janar 2010,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotyësimin e Ligjit për duhanin 02 L-36,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për turizëm dhe shërbime turistike dhe
11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me Propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 28 janar 2010

Kuvendi miratoi pa vërejtje Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 28 janar 2010.

Deputeti **Driton Tali** pati vërejtje në transkriptin e seancës plenare, të mbajtur më 28 janar 2010, në faqe 78 e 79.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Idriz Vehapi, lidhur me krijimin e fondit për bujqësi dhe ndihmën e ministrisë për fermerët në subvencionimin e një pjese të kamatave.

Ministri Idriz Vehapi i'u përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja **Suzan Novobërdaliu** parashtroi pyetje për ministrin e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, Fatmir Limaj, lidhur me kohën e fillimit të punimeve për ndërtimin e autostradës Morinë- Prishtinë- Merdare.

Ministri Fatmir Limaj i'u përgjigj pyetjes së deputetes Novobërdali.

Deputetja **Drita Maliqi** parashtroi pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Idriz Vehapi, lidhur me veprimet e ministrisë për punësimin e të rinjëve në sektorë të ndryshëm të bujqësisë.

Ministri Idriz Vehapi i'u përgjigj pyetjes së deputetes Maliqi.

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministrin Ahmet Shala lidhur me moszbatimin e nenit 6 të Ligjit nr.03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës.

Ministri Ahmet Shala nuk ishte prezent në seancë.

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministrin Lutfi Zharku lidhur me mospërfilljen e nenit 4 të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve.

Ministri Lutfi Zharku nuk ishte prezent në seancë.

Deputetja **Myrvete Pantina** parashtroi pyetje për ministrin Ahmet Shala lidhur me procedimin e Projektligjit për sigurimin e depozitave bankare.

Ministri Ahmet Shala nuk ishte prezent në seancë.

Deputeti **Naim Rrustemi** parashtoi pyetje për ministren Justin Shiroka-Pula lidhur me operimin e Elektroekonomisë së Serbisë në teritorin e Kosovës.

Ministrja Justin Shiroka-Pula nuk ishte prezent në seancë.

Deputeti **Naim Rrustemi** parashtoi pyetje për ministrin Ahmet Shala lidhur me garancinë bankare prej 16 milionë euro, të operatorit të dytë të telefonisë mobile.

Ministri Ahmet Shala nuk ishte prezent në seancë.

Deputetja **Suzan Novobërdaliu** parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi ose njërin nga zëvendëskryeministrat lidhur me ate se kush e furnizon me energji elektrike pjesën veriore të Kosovës.

Kryeministri Hashim Thaçi dhe asnjëri nga zëvendëskryeministrat nuk ishin prezent në seancë.

Deputetja **Suzan Novobërdaliu** parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi ose njërin nga zëvendëskryeministrat lidhur me rezultatet e investimeve të huaja në Kosovë, për vitin 2009.

Kryeministri Hashim Thaçi dhe asnjëri nga zëvendëskryeministrat nuk ishin prezent në seancë.

Deputetja **Drita Maliqi** parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me veprimet e Qeverisë për punësimin e të rinjëve.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte prezent në seancë.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës

Kryetari konstatoi se në mungesë të përfaqësuesit të Qeverisë për ta prezantuar Projektligjin para deputetëve të Kuvendit, Projektligji për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës shtyhet për tre muaj.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi zëvendëskryeministrin Ramë Manaj që para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

Ramë Manaj tha se edhe pse aktualisht kjo fushë është e rregulluar për kah ana ligjore, Projektligji të cilin po e shqyrtojmë sot i eliminon zbrazësitë ligjore ekzistuese.

Ky projektligj rregullon procedurat për publikimin e “Gazetës zyrtare”, si dhe përgjegjësitë e Zyrës për publikimin e saj. Në “Gazetën zyrtare” do të publikohen ligjet

dhe aktet tjera të institucioneve të Republikës së Kosovës. Ky projektligj është i harmonizuar me legjislacionin e së drejtës së BE-së për këtë fushë. Në fund, ai i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sanije Aliaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Enis Kervan, si dhe deputetët: Mahir Jagcillar, Gjylnaze Syla, Arsim Rexhepi, Ibrahim Makolli, Sadik Idriz, Sabri Hamiti dhe Ramë Manaj, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Për shkak të defekteve teknike, u votua në mënyrë hapur, me ngritje dore. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për--- Shumica absolute,
Kundër -----1,
Abstenime----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Projektligjin për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Kryesuesi ftoi zëvendëskryeministrin Ramë Manaj që para deputetëve të prezantojë projektligjin.

Ramë Manaj tha se ky projektligj është paraparë në Strategjinë legjislative për vitin 2009, dhe ka për qëllim organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Me këtë projektligj rregullohet në detaje funksionimi i Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës. Me miratimin e këtij projektligji do të zbatohet neni 101 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, potencioi ai.

Në fund, ai i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, Ali Lajçi, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hydajet Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Melihate Termkolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bajram Kosumi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Esat Brajshori, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush si dhe deputetët: Ramadan Avdiu, Ibrahim Makolli, Luljeta Shehu, Armend Zemaj, Gani Buçinca, Ismet Beqiri, Gjylnaze Sylaj, Bahri Hyseni, Bujar Dugolli, Nyrisha Hula, Riza Smaka, Naim Rrustemi, Adem Salihaj, Berim Ramosaj dhe Shkumbin Demaliaj, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Për shkak të defekteve teknike, u votua mënyra e hapur, me ngritje dore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----53,

Kundër-----3,

Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryesuesi ftoi ministren Nekibe Kelmendi që para deputetëve të prezantojë Projektligjin. **Nekibe Kelmendi** tha se Republika e Kosovës deri më tani nuk ka pasur ligj për ekzekutimin e sanksioneve penale, por ka pasur një rregullore të UNMIK-ut në të cilën është dashur të ndryshohen mbi 100 nene, prandaj kjo është arsyeja pse jemi përcaktuar për hartimin e projektligjit të ri.

Në vazhdim ajo nënvizoi se qëllimi i këtij projektligji është ekzekutimi i sanksioneve penale, përfshirë këtu: dënimet alternative, risocializimin e të dënuarve, preventivën në shkaktimin e veprave penale etj.

Projektligji në fjalë është në pajtim me standardet ndërkombëtare nga kjo fushë dhe me Konventën Evropiane për Personat e Burgosur, potencoi ajo.

Ministria, tha se ky projektligj parasheh qe zyrtaret korrektoes te kenë një status të njejtë me atë të policëve. Po ashtu nënvizoi se projektligji parasheh formimin e Inspektoratit për Shërbimin Korrektues.

Në fund ajo i ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bajram Kosumi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Shkumbin Demaliaj, Riza Smaka, Gani Buçinca, Ramadan Avdiu, Berat Luzha dhe Nekibe Kelmendi, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Për shkak të defekteve teknike u votua mënyra e hapur, me ngritje dore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----74,

Kundër-----0,

Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor ose raportuesin e Komisionit, që ta marrë fjalën.

Pasi që nuk kishte të paraqitur tjerë për diskutim nga Komisioni funksional, e as nga deputetët, **kryesuesi** i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63,
Kundër-----0,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin 02 L-36

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ose raportuesin e Komisionit, që ta marrë fjalën.

Pasi që nuk kishte të paraqitur për diskutim nga Komisioni funksional e as nga deputetët tjerë, **kryesuesi** i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4 dhe 5

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër-----2,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin 02 L-36.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi ose raportuesin e Komisionit, që ta marrë fjalën.

Bahri Hyseni i arsyetoi amendamentet e paraqitura nga Komisioni funksional dhe i ftoi deputetët për miratim të atyre amendamenteve.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13
U votua për heqjen e paragrafit 1.3 të amendamentit nr. 3.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,
Kundër-----0,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarve të lartë publik.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për turizëm dhe shërbime turistike

Për Raportin e Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion diskutuan këta deputetë: Naser Osmani, Bujar Dugolli, Lutfi Zharku, Sabri Hamiti, Armend Zemaj, Bahri Hyseni, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli, Edita Tahiri dhe Riza Smaka.

Pastaj, **kryesuesi** i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13,14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24 dhe 26.

Kuvendi nuk miratoi amendamentin: 25.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----46,
Kundër-----16,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Projektligjin për turizëm dhe shërbime turistike.

11. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me Propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës

Deputeti **Bahri Hyseni**, në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, e paraqiti rekomandimin dhe arsyetimin e tij.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----41,
Kundër-----11,
Abstenime-----8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve dhe të zëvendësanëtarit të Komisionit për Provimin e Jurisprudencës

1. Adem Vokshi, emërohet anëtar i Komisionit për Provimin e Jurisprudencës, për lëndët civile.
2. Asllan Bilalli, emërohet anëtar i Komisionit për Provimin e Jurisprudencës, për lëndën - E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
3. Remzije Istrefi, emërohet zëvendësanëtare e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës për lëndën - E drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
4. Mandati i anëtarit dhe i zëvendësanëtares së Komisionit për Provimin e Jurisprudencës zgjatë dy (2) vjet.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 18:33 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale**